



BASHKIA E TIRANËS
Nr. prot. 5720, datë 04/06 /2012



FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE
Nr. prot. 946, datë 24/05 /2012

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Nënshkruar sot më datë 24 / 05 /2012, ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Bashkia e Tiranës, përfaqësuar nga zv.Kryetari, **Prof. Dr. Edmond Panariti**, me adresë: Shëtitorja "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Skënderbej", këtu e në vijim e quajtur "Bashkia";

dhe

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, përfaqësuar nga **Prof.Dr. Dhimitër Rapti**, dekan i Fakultetit, me adresë; Kodër Kamëz, këtu e në vijim i quajtur "Fakulteti";

Nisur nga shqetësimi serioz i komunitetit të qytetit të Tiranës, për fenomenin e qenve endacakë, me synim administrimin e kësaj situatë, palët bien dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi, si më poshtë vijon:

Neni 1 **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është funksionimi i qendrës së specializuar për qentë endacakë, e cila do të vazhdojë të ketë në fokus kryesor, trajtimin e tyre.

Neni 2 **Qëllimi**

Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin midis palëve në drejtim të funksionimit të shërbimit të profesionalizuar për qentë endacakë në qytetin e Tiranës me qëllim minimizimin e rrezikut nga zoonozat.

Neni 3 **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi mbështetet në Ligjin nr.8652, datë 31.7.2000, për "Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", (i ndryshuar), neni 10, pika 1 dhe pika 3/III/d, si dhe në Ligjin nr.10 465, datë 29.09.2011, për "Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", neni 54, "gërma ç".

Neni 4 **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

4.1 Fakulteti merr përsipër:

- a- Të ofrojë godinën për funksionimin e qendrës për trajtimin e kafshëve, në ambjentet e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, e cila përfshin klinikën veterinarë dhe vendqëndrimin e qenve.
- b- Të administrojë qendrën nga një staf i specializuar, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.
- c- Të raportojë periodikisht, pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit për problemet që dalin gjatë procesit të punës.

4.2 Bashkia merr përsipër:

- a- Të financojë detyrimet e mbetura për rikonstruksionin e godinës së ofruar nga fakulteti.
- b- Të ofrojë realizimin e fushatave sensibilizuese.
- c- Të ofrojë mjetin për transportin e qenve në qendër dhe anasjelltas.
- d- Të ofrojë stafin e punonjësve për kapjen e qenve si dhe transportimin e tyre.
- e- Të financojë bazën materiale gjatë periudhës së zbatimit të projektit.

Neni 5 **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje është 3 (tre) vjet, duke nisur nga data e hyrjes në fuqi të saj. Ky afat mund zgjatet, nëse palët bien dakord për rinovimin e saj.

Neni 6 **Zbatimi i marrëveshjes**

6.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

6.2 Palët nënshkruese, duke marrë në konsideratë faktorë dhe probleme të reja që mund të dalin gjatë periudhës së mësipërme, në mirëkuptim të përbashkët, mund të ndryshojë dhe plotësojë marrëveshjen.

Neni 7 **Zgjidhja e mosmarrëveshjes**

Palët do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët.
Hartohet në 4 (katër) kopje identike, nga 2 kopje për secilën palë.

Për Bashkinë e Tiranës


Prof. Dr. Edmond Panariti

Zv. Kryetar

